

VENDIM
Nr. 447, datë 22.5.2017

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT TË
INVESTIMEVE PËR FUNKSIONIN E
SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA
ZJARRI DHE SHPËTIMIN NË DISA
NJËSI TË VETËQEVERISJES VENDORE,
PËR VITIN 2017**

Në mbështetje pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 16, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe të pikës 76, të udhëzimit nr. 8, datë 13.1.2017, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi për investime, për funksionin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, miratuar në buxhetin e vitit 2017, në shumën 20 000 000 (njëzet milionë lekë), shpërndahet për blerje automjesh dhe pajisjesh zjarrfikëse, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, si organ qendror blerës, për kryerjen e prokurimit të fondit limit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, si shumë e fondeve për secilën prej bashkive përfituese.

3. Fondet e papërdorura, të mbetura pas përfundimit të procesit të prokurimit dhe lidhjes së kontratave, sipas pikës 2, të këtij vendimi, rishpërndahen për bashkitë e tjera, me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përfituese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

TABELA NR. 1
SHPËRNDARJA E FONDIT TË INVESTIMEVE PËR FUNKSIONIN E SHËRBIMIT TË
MZSH-SË PËR 5 NJËSI TË VETËQEVERISJES VENDORE, PËR BLERJE
AUTOMJETESH DHE PAJISJESH ZJARRFIKËSE

Bashkitë	Emërtimi i investimit	Vlera
Shijak	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Divjakë	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Këlcyrë	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Ura Vajguore	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Fushë Arëz	Blerje (automjete dhe pajisje zjarrfikëse).	4 000 000 lekë
Totali		20 000 000 lekë

